

## ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për: **KOMUNA E PODUJEVËS**

Për Aktivitetin e Prokurimit:

|                 |                   |
|-----------------|-------------------|
| Nr i Prokurimit | 615-26-4003-1-2-1 |
| Nr i brendshëm  |                   |

## A N K E S Ë

### I. Identifikimi i ankuesit\*

AGRIUM SH.P.K

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

RR. Skenderbeu Nr. 815,

(Adresa)

Ferizaj

(Vendi)

70000

(Kodi postar)

+38344746764

(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

Leutrim Isufi

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

info@agrium-ks.com

(Adresa elektronike)

24.08.2026

(Data e parashtrimit të kërkesës)

   
(Nënshkrimi dhe vula)

## 2. Identifikimi i avokatit

*Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.*

*Shëno të dhënat si në vijim:*

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të kërkesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

## 3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

*[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:*

Ky aktivitet i prokurimit ka të bëjë me tenderin: “**Subvencionim për shpezëtari**” i ritenderuar. Njoftimi për kontratë është bërë me datën 26.05.2026. Hapja e Dosjes të Tenderit ka qene me date: 22.06.2026. AK ka shpallur fitues kompanine tone ndersa me date: 28.07.2026 eshte bere Kerkese per Rishqyrtim prane AK-se ku AK e ka aprovuar si te Bazuar po ne te njejten date, dhe me date 05.08.2026 ka leshuar dokumentin B58 Njoftimin mbi vendimin e Ak-se duke shpallur fitues nje kompani tjeter. Të pakenaqr me kete vendim bejme Kërkesë për Rishqyrtim pranë AK – **KOMUNA E PODUJEVËS** Pas vendimit për refuzim të Kërkesës për Rishqyrtim dhe në afat të rregulltë kohorë parashtrojmë Ankesë pranë OSHP-së.

## 4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

*A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.*

Po ☒

Jo ☐

## 5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

*A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?*

Po ☒

Jo ☐

## 6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

*Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.*

- 1. Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar - veçanërisht nenet 7, 59, 69, 72 dhe 109.**
- 2. KRPP - interpretimet ligjore për nenin 72: kur dokumentacioni/informacioni është jo i plotë ose mungon, mund të kërkohet plotësim/sqarim për dokumente/fakte ekzistenca e të cilave është e fiksuar para afatit dhe verifikohet objektivisht.**
- 3. Raporti Vjetor i KRPP-së 2022, ku neni 69.2.1 përshkruhet si 'lista e furnizimeve kryesore në tre vitet e fundit'.**
- 4. Interpretimet e KRPP-së për nenin 69, të cilat përdorin termin 'Lista e kontratave të realizuara' për dëshmimin e përvojës teknike/profesionale.**

## 7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

*Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuara për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.*

**Pretendimi nr. 1:** Arsyetimi qendror i Vendimit të 14.08.2026 është se Aneksi 6 qenka 'dokumenti kryesor dhe i detyrueshëm' dhe se kontratat që nuk janë përsëritur brenda tij nuk mund të merren parasysh. Ky përfundim nuk është mbështetur në një dispozitë konkrete të LPP-së që i jep Aneksit 6 efekt ekskluziv.

Pas ekzaminimit të kërkesës për rishqyrtim dhe shqyrtimit të sërishëm të dosjes së tenderit, gjegjësisht ofertës Autoriteti Kontraktues konstaton se formulari "Aneksi 6", Përvoja në realizimin e kontratave të ngjashme është dokumenti kryesor dhe i detyrueshëm në të cilin operatori ekonomik duhet të deklarojë qartë dhe saktë kontratat e realizuara që përmbushin kërkesat e dosjes së tenderit, siç e pranon edhe vetë parashtruesi i kërkesës, në aneksin 6, ka deklaruar vetëm një

kontratë "Furnizim me inkubator" në vlerë prej 780.00 € dhe kjo vlerë është dukshëm më e ulët se pragu i kërkuar prej 63,000.00 € e përcaktuar në pikat 9.1 & 9.2 të FDT-së.

**Pretendimi se kemi dorëzuar vetëm një kontratë prej 780.00 € është faktikisht i pasaktë.** Është e saktë se në Aneksin 6 është shënuar kontrata "Furnizim me Inkubator" në vlerë 780.00 €. Mirëpo, në të njëjtën ofertë dhe para afatit të tenderimit kemi dorëzuar si dokument të veçantë edhe "List of Contracts.pdf", ku janë të listuara kontratat tona të realizuara. Vetë Formulari B66 i dorëzimit të tenderit e evidenton veçmas "Aneksi 6.pdf" dhe "List of Contracts.pdf".

#### Lista e dokumenteve të tenderit mbështetëse

| Nr. | Dokument                                      |
|-----|-----------------------------------------------|
| 1.  | SIGURIMI I TENDERIT.pdf                       |
| 2.  | DEKLARATA NËN BETIM.pdf                       |
| 3.  | Aneksi1.pdf                                   |
| 4.  | Aneksi 6.pdf                                  |
| 5.  | CD 2024.pdf                                   |
| 6.  | DOKUMENTET E BIZNESIT.pdf                     |
| 7.  | ISO 9001 - AGRIMUM SH.P.K. _EN.pdf            |
| 8.  | List of Contracts.pdf                         |
| 9.  | IADK - GENERATOR - INKUBATOR - 28.10.2024.pdf |

Përkundrazi, neni 69.2.1 i LPP-së e përkufizon dëshminë për furnizime si LISTË me furnizimet kryesore të rëndësishme, ku shënohen produktet, shuma, data dhe pranuesi. Edhe materialet interpretuese të KRPP-së i referohen nenit 69.2.1 si 'lista e furnizimeve kryesore në tre vitet e fundit'. Kjo është pikërisht natyra e dokumentit 'List of Contracts.pdf' që ka qenë pjesë e ofertës origjinale.

AGRIUM nuk pretendon se Aneksi 6 është i parëndësishëm apo se nuk duhej dorëzuar. Aneksi 6 është dorëzuar. Çështja është tjetër: a mundet AK të injorojë një listë të kontratave që ka qenë e ngarkuar brenda të njëjtës ofertë, para afatit, vetëm sepse të njëjtat të dhëna nuk janë kopjuar edhe në tabelën e Aneksit 6? Sipas ankuesit, një përfundim i tillë nuk del nga neni 69.

Më tej, vetë Aneksi 6 parashikon bashkëngjitjen e certifikatave përkatëse ose dokumenteve të tjera që evidentojnë performancën. Kjo e dobëson edhe më tej tezën se tabela e Aneksit 6 duhet të lexohet e izoluar nga dokumentacioni tjetër i tenderit.

Fakti që Aneksi 6 nuk i ka përfshirë të gjitha kontratat brenda tabelës së tij nuk e zhduk dokumentin tjetër të dorëzuar në të njëjtën ofertë. Për më tepër, vetë Aneksi 6 parashikon që t'i bashkëngjiten certifikatat përkatëse ose dokumente të tjera që evidentojnë performancën. "List of Contracts.pdf" ka qenë pjesë integrale e ofertës dhe është dashur të merret në konsideratë gjatë vlerësimit.

Po ashtu AK ka kërkuar nga ne si OE përmes **B47 Letër Standarde e kërkeses per**



Pra, gjatë vlerësimit fillestar, AK e ka identifikuar dhe përdorur 'List of Contracts' si bazë për të kërkuar referencat. AGRIMUM ka vepruar sipas kërkesës së AK-së dhe ka dorëzuar dëshmitë brenda afatit. Pas ankesës së operatorit tjetër, AK merr qëndrim të kundërt: lista që vetë AK e kishte njohur si listë të kontratave tani trajtohet sikur të mos mund të prodhojë asnjë efekt sepse kontratat nuk janë përsëritur në Aneksin 6.

Një administrim i tillë i të njëjtit dokument me dy standarde të ndryshme cenon konsistencën, transparencën dhe vlerësimin objektiv. Nëse 'List of Contracts' nuk kishte asnjë vlerë juridike për kualifikim, atëherë nuk shpjegohet pse AK, më 07.07.2026, kërkoj pikërisht referencat e kontratave të asaj liste.

Pra AK bie në kontradite me kesaj kërkesë dhe refuzimin apo aprovimin e Kërkesës për Rishqyrtim nga OE tjetër apo me vetë dokumentin **B 58 Vendimi i Ak-së** të datës 05.08.2026!

**Pretendimi nr. 2: Vendimi i 14.08.2026 arsyeton se pranimi i kontratave/referencave që nuk janë deklaruar në formularin bazë do të përbënte ndryshim material pas hapjes së ofertave. Ky arsyetim nuk i përgjigjet faktit konkret të kësaj lënde: kontratat nuk po paraqiten për herë të parë pas afatit, pra **nuk po kërkohet ndryshim material i ofertës; informacioni dhe ekzistenca e kontratave ishin të evidentuara para afatit!****

'List of Contracts.pdf' ishte dokument i ofertës fillestare. Kontratat e listuara ishin realizuar para afatit. Referencat/certifikatat kanë të bëjnë me fakte historike, ekzistenca e të cilave është e fiksuar dhe e verifikueshme objektivisht. Kjo është pikërisht logjika e nenit 72.3 të LPP-së.

KRPP, në interpretimin e nenit 72, sqaron se informacioni/dokumentacioni mund të plotësohet ose sqarohet kur ekzistenca e dokumentit/faktit është e fiksuar para afatit dhe mund të verifikohet objektivisht. Në rastin tonë, jo vetëm që ekzistenca e kontratave ishte e fiksuar, por vetë lista e tyre ishte dorëzuar në ofertën fillestare dhe AK e kishte identifikuar atë para marrjes së vendimit të parë.

Prandaj, AGRIMUM nuk kërkon të shtojë kapacitet të ri, kontratë të re apo përvojë të krijuar pas afatit; kërkon që të vlerësohet kapaciteti që ekzistonte dhe ishte deklaruar në ofertë. Kjo është dallim thelbësor nga një ndryshim material i tenderit.

### **Pretendimi nr. 3:**

**AK ka kërkuar: 2.1. Kriteri i Dosjes së Tenderit kërkon “kontrata të ngjashme”, jo kontrata identike.** Në pikën 9.1 & 9.2 të FDT-së është kërkuar që OE të ketë përfunduar me sukses kontrata të ngjashme në vlerë prej 63,000.00 € (furnizime) gjatë 3 viteve të fundit. Dosja nuk kërkon që kontratat të jenë identike me objektin konkret, vetëm për shpezëtari apo vetëm për inkubatore, e cila po ashtu do të ishte e jashtëligjshme! Prandaj, interpretimi i mëvonshëm i kriterit si “kontrata identike” është më kufizues se kriteri i publikuar dhe bie ndesh me parimet e trajtimit të barabartë, transparencës dhe konkurrencës.

**2.2. AGRIMUM SH.P.K. ka dëshmi për furnizime të ngjashme që tejkalojnë prapun e kërkuar.** Ndër të tjera, kemi realizuar kontratën me Komunën e Ferizajt për “Furnizimi i fermerëve me inpute bujqësore - plehra artificiale” në vlerë 84,000.00 €, e cila vetë tejkalon prapun 63,000.00 €. Kemi gjithashtu kontrata të tjera relevante në sektorin bujqësor,

përfshirë furnizime me folie dhe sistem ujitjeje, fidane, substrate dhe materiale të tjera bujqësore.

Autoriteti Kontraktues nuk mund të përcaktojë një kriter si **“kontrata të ngjashme – furnizime”** dhe pastaj, gjatë rivlerësimit, ta interpretojë atë në mënyrë aq restriktive sa praktikisht të kërkojë eksperiencë identike në shpezëtari.

Nëse AK ka synuar që vetëm kontratat e furnizimit me pajisje/materiale të shpezëtarisë të pranohen, kjo është dashur të përcaktohej **shprehimisht, qartë dhe paraprakisht në Dosjen e Tenderit, e cila poashtu bie ndeshë me ligjin e LPP-se.**

Nuk është e lejueshme që standardi i kualifikimit të ndryshohet pas dorëzimit dhe hapjes së ofertave. Një interpretim i tillë jo vetëm që dëmton AGRIMUM SH.P.K., por kufizon artificialisht konkurrencën dhe bie ndesh me qëllimin e prokurimit publik.

**Për më tepër, kontratat e paraqitura nga AGRIMUM SH.P.K. janë drejtpërdrejt relevante dhe të natyrës së ngjashme me aktivitetin konkret të prokurimit.** Nuk kemi të bëjmë me kontrata nga një sektor i ndryshëm apo me një objekt tërësisht të palidhur, por me **kontrata furnizimi në sektorin bujqësor**, disa prej të cilave kanë pasur për qëllim pikërisht **subvencionimin dhe furnizimin e fermerëve me produkte, inpute dhe materiale bujqësore.** Ndër to përfshihet kontrata me Komunën e Ferizajt për “Furnizimin e fermerëve me inpute bujqësore – plehra artificiale” në vlerë 84,000.00 €, si dhe kontrata të tjera për furnizimin e fermerëve me folie, sisteme të ujitjes, fidane dhe produkte të tjera bujqësore.

Edhe aktiviteti aktual **“Subvencionim për shpezëtari”** është procedurë e tipit **FURNIZIM** dhe realizohet në kuadër të sektorit bujqësor me qëllim subvencionimin/furnizimin e përfituesve. Vetë Dosja e Tenderit e klasifikon aktivitetin si “FURNIZIM”, ndërsa kriteri 9.1 & 9.2 kërkon shprehimisht **“kontrata të ngjashme në vlerë prej 63,000.00 € (furnizime)”**.

Prandaj ekziston ngjashmëri e qartë në natyrën e kontratave, llojin e aktivitetit ekonomik, sektorin ku realizohen dhe mënyrën e realizimit të furnizimit. Ndryshimi i produktit konkret që furnizohet – p.sh. inpute bujqësore, fidane, sisteme ujitjeje apo produkte për shpezëtari – **nuk e shndërron një kontratë furnizimi bujqësor në kontratë të një natyre tjetër.**

Nëse Autoriteti Kontraktues ka synuar që si përvojë të pranohen **vetëm kontrata për shpezëtari, inkubatorë apo produkte identike me artikujt e kësaj procedure**, një kufizim i tillë është dashur të përcaktohej **qartë dhe shprehimisht në Dosjen e Tenderit para dorëzimit të ofertave.** Një kërkesë e tillë nuk është përcaktuar. Përkundrazi, AK ka përdorur termin më të gjerë **“kontrata të ngjashme – furnizime”**.

**Rrjedhimisht, AK nuk mundet që pas hapjes së ofertave ta ngushtojë kuptimin e kriterit “të ngjashme” dhe ta zbatojë atë sikur Dosja e Tenderit të kishte kërkuar “kontrata identike”.** Një interpretim i tillë do të nënkuptonte aplikimin gjatë fazës së vlerësimit të një standardi më kufizues se ai që u është bërë i ditur operatorëve ekonomikë në momentin e tenderimit.

Kërkojmë që:

**-APROVOHET** si e bazuar ankesa e OE AGRIMUM SH.P.K. lidhur me tenderin “**Subvencionim për shpezëtari** ” me nr. tenderit: “**615-26-4003-1-2-1**”i iniciuar nga **KOMUNA E PODUJEVËS**

**-TË ANULOHET** vendimi i AK - **KOMUNA E PODUJEVËS** për dhënje të kontratës të prokurimit dhe lënda të kthehet në ri-vlerësim. Ri-vlerësimi të bëhet bazuar në kërkesat e dosjes së tenderit e që realisht më pas do duhej që Fitues te shpallej OE “AGRIUM SH.P.K.” sic ishte shpallur parimisht!

## 8. Dëmet materiale

*Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t’iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.*

Mosdhënia e kësaj kontrate kompanisë tonë rrezikon të na shkaktoj dëme materiale për vlerën e fitimit të munguar dhe shpenzimet e përgatitjes së tenderit njëkohësisht do të bëjë dëmtimin e reputacionit tonë si njëra ndër kompanitë më të njohura për shitjen e këtyre artikujve etj.

## 9. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

*Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:*